

VENDIM
Nr. 211, datë 1.12.2022

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË KOALICIONIT “PARTIA DEMOKRATIKE-ALEANCA PËR NDRYSHIM”, QARKU TIRANË, Z. PETRIT DINE DODA

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163 pika 7, 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe të kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 3734/1 prot., datë 9.11.2022, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar si pasojë e dorëheqjes nga mandati i deputetit të z. Alfred Gjovalin Rushaj, i zgjedhur në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, propozuar nga koalicioni “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim”. Koalicioni “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim”, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 107, datë 2.3.2021.

Komisioni Rregullator me vendimin nr. 21, datë 13.7.2021, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të zhvilluara më datë 25.4.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet vendimit nr. 409, datë 23.6.2021, miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimin e kandidatëve fitues, si dhe rirenditjen e kandidatëve të cilët nuk kanë përfituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25.4.2021.

Sipas këtij vendimi koalicioni “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim” për zonën zgjedhore, qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25 prill 2021, ka fituar 15 (pesëmbëdhjetë) mandate.

Rezulton se lista shumëmemërore e koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim”, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë.

Zëvendësimi i vakancës do të bëhet në mbështetje të nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si dhe vendimit nr. 409, datë 23.6.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në të cilin është miratuar rirenditja e kandidatëve, të cilët nuk kanë përfituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese.

Sipas këtij vendimi, rezulton se, kandidatit të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati me numër rendor 16 (gjashtëmbëdhjetë), z. Petrit Dine Doda.

Me shkresën nr. 3544 prot., datë 10.11.2022, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për deputet, të listës shumëmemërore të koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim”, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, z. Petrit Dine Doda, me kërkesë për plotësim dokumentacioni. Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të

të dhënave, në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant. Kandidati për deputet, z. Petrit Dine Doda, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 52 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i deputetit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe të kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, me shkresën nr. 3616 prot., datë 18.11.2022, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 3618 prot., datë 18.11.2022, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për z. Petrit Dine Doda, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për deputet në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Petrit Dine Doda.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 13597/1 prot., datë 21.11.2022, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Petrit Dine Doda, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Pas verifikimeve të kryera, referuar pikës 2, të kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, konstatohet se të dhënat e kandidatit për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Petrit Dine Doda, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetit z. Alfred Gjovalin Rushaj i përket kandidatit vijues në listën shumemërore të koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim”, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, i renditur me numër rendor 16 (gjashtëmbëdhjetë), z. Petrit Dine Doda.

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163, pika 7, 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; në nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe në kreun V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

VENDOS:

1. Dhënen e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim”, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, z. Petrit Dine Doda.

2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tri) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONER SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Ilirjan Celibashi

